

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.05.2023*

13.05.2023
Ora 21:10

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorëve për kërkesën ankimore nr. 60”.

PJESËMARRJA :

- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj

Z. Y. Merkaj: Atëhere, përshëndetje të gjithëve. Sot në datën 13 maj, ora 21.10 minuta, zhvillohet procedura për hedhjen e shortit për përcaktimin e relatorit, kërkesa ankimore numër 60, me kërkues Partia Levizja Bashkë, e cila kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 496 datë 11.05.2023. vlerësimi i raportit të monitoruesit të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 maj dhe 10 maj 2023. Procedura e shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita ku në njërin është shënuar kërkesa ankimore numër 60, katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat pasi palosen futen në gogla me peshë dhe ngjyrë të njëjtë në një enë transparente. Duke qënë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm në hedhjen e shortit kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së për të tërhequr goglat në enën transparente, në emër dhe për llogari të tyre. Duke filluar nga numri alfabetik rritës me zotin Elvin Lako fillimisht, pastaj Elvis Çepa, Ilirjan Rusmaili, Koli Bele dhe në fund zotin Ledio Braho. Pas përzjejmë goglat nga përfaqësuesi i KQZ-së.

-Tërhiqet gogla -Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ervin Lako: - shiriti është i bardhë dhe pa shënime .

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Elvis Çepa: - Kërkesa ankimore numër 60.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.05.2023*

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ilirjan Rusmali: - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Koli Bele: - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në fund, në emër dhe për llogari të:

Z. Ledio Braho: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Atëhere, në përfundim të procedurës së shortit është caktuar si relator i kërkesës ankimore me numër 60, zoti Elvis Çepa. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.05.2023*

**13.05.2023
Ora 21:35**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 60, subjekti ankues Partia Lëvizja Bashkë”.

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa,
Z. Ledio Braho,
Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Horanlliu, Z. K. Puleri.
Të tjerë: S’ka prezent

Z. E. Çefa: Mirëmbërëma të gjithëve! Deklaroj të çelur seancën për shqyrtimin paraprak të elementëve të formës dhe të përmbajtjes lidhur me kërkesën ankimore numër 60, datë 13 maj 2023, paraqitur nga subjekti zgjedhor, partia “Lëvizja Bashkë”, me përfaqësues zotin Arlind Qorri dhe me objekt ‘Kundërshtimin e vendimit numër 496, datë 11 maj 2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për peridhën e monitorimit 9 maj deri në 10 maj’. Është prezent KAS-i, përbërja e të cilit e lejon korumin e nevojshëm për të vlerësuar elementët formal të kësaj kërkesë, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Megjithëse ka dijeni rregullisht ankimuesi deri në këtë fazë ende nuk është paraqitur. Relatori i kësaj kërkesë sipas shortit hedhur po sot në KQZ jam unë, anëtari Elvis Çefa. Atëhere fillojmë sipas procedurës, shkurtimisht zoti Merkaj, një relativitet të shkurtër për kërkesën dhe opinionin tuaj lidhur me plotësimin ose jo të elementëve formal të saj. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.05.2023*

Z. Y. Merkaç: Po, faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 60, me ankues Partia Levizja Bashkë, e cila kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 496, datë 11.05.2023, për vlerësimin e raporteve të monitoruesëve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 maj dhe në 10 maj 2023 ku në fund të procedimit administrativ Komisioneri ka vendosur urdhërimin e subjektit zgjedhor Lëvizja Bashkë dhe Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Tiranë, për mbylljen e menjëherëshme të zyrës zgjedhore, me adresë pranë shkollës 'Avni Mula' në Tiranë. Duke parë dhe verifikuar elementët formal të kërkesës ankimore konstatohet se i plotëson të gjitha kërkesat sipas nenit 130, të Kodit Zgjedhor. Ju faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit juve! Nga kolegët pyetje? Atëhere KAS i konsultuar në vend vendosi kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 60, datë 13.05.2023, me subjekt ankimues Partinë Lëvizja Bashkë, përfaqësuar nga zoti Arlind Qorri. Për shkak të rrethanave të ngutëshme të çështjes seanca e shqyrtimit të themelit do të bëhet në orën 22.00, pra për 13 minuta, po këtu. Me kaq e deklaroj të mbyllur këtë seancë. Faleminderit!

Vendimi nr. 110

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.05.2023*

**13.05.2023
Ora 22:01**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Shqyrtimi në themel i kërkesës ankimore nr. 60, subjekti ankues Partia Lëvizja Bashkë”.

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa,
Z. Ledio Braho, Z. Koli Bele

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Horanlliu, Z. K. Puleri.

Të tjerë: S’ka prezent

Z. E. Çefa: Mirmbërëma të gjithëve! Atëhere fillojmë seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore me numër 60, datë 13 maj 2023, me subjekt ankimes subjektit zgjedhor Partia Lëvizja Bashkë, përfaqësuar nga zoti Arlind Qorri kryetar i saj, me objekt ‘Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me numër 496, datë 11 05 2023’, vendim i cili titullohet ‘Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore, për periudhën e monitorimit 9 maj -10 maj 2023. Sipas shortit relator i kësaj çështje jam caktuar unë, anëtari Elvis Çefa. Verifikojmë fillimisht prezencën, është prezent KAS-i përbërë nga katër anëtarë, që do të thotë që nuk ka asnjë lloj pengese për formimin e korumit për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore, është prezent Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Megjithëse ka dijeni rregullisht nuk është prezent përfaqësuesi i ankimesit, fakt i cili nuk e pengon këtë komision që të vijojë me procedurën e shqyrtimit të ankimit. Atëhere sipas procedurës, meqënëse nuk kemi prezent ankimesin, ja jap fjalën përfaqësuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për një

**Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.13.05.2023

parashtrësë të shkurtër të rrethanave të faktit të ankimit. Faleminderit! Zoti Merkaj
fjala për ju.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 11 05 2023 ka marr vendim për vlerësimin e raporteve të monitoruesëve të fushatës zgjedhore, për periudhën e monitorimit data 9 maj- 10 maj 2023. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka caktuar 120 monitorues të fushatës zgjedhore për të monitoruar fushatën e datës 14 maj 2023. Për periudhën 9 maj deri në 10 maj janë administruar gjithësej 45 raporte monitorimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga vlerësimi që i është bërë këtyre gjetjeve të këtyre raporteve për këtë periudhë, rezulton se katër prej tyre pasqyrojnë shkelje për hapjen e zyrave zgjedhore nga subjektet zgjedhore: Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Lëvizja Bashkë, të cilat nuk kanë respektuar nenin 5, pika 1, të udhëzimit numër 6, datë 23.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ku përcaktohet se zyrat zgjedhore nuk mund të hapen në një distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve ose e Qendrave të Votimit ose vendit të numërimit të votave. Duke qënë se në raportin e monitorimit është raportuar që Lëvizja Bashkë ka hapur një zyrë zgjedhore më të afërt se kjo distancë, atëhere Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përfundim të hetimit administrativ ka urdhëruara subjektin zgjedhor Lëvizja Bashkë, Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake Tiranë, për mbylljen e menjëherëshme të kësaj zyre e cila është në afërsi shkollës 'Avni Mula', e cila është dhe si Qendër Votimi. Në këto kushte i kërkojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Pyetje nga kolegët?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.05.2023*

Z. L. Braho: Atëhere nga vendimi i Komisionerit del që një nga zyrat që është mbyllur thotë që është zyrë e subjektit zgjedhor Lëvizja Bashkë, në Bashkinë Tiranë, 20 metër nga shkolla “Avni Mula”, ndërkohë nga ankimimi, pala ankimuese pretendon se në rrugën Abdulla Keta ka selinë e partisë që vërtetohet dhe nga shkurtimit i vendimit të gjykatës. A mund të na konfirmoni që bëhet fjalë për të njëjtin pozicionim, meqënëse vendimi i Komisionerit nuk ka emër rruge por ka thjeshtë largësi nga shkolla “Avni Mula”. A bëhet fjalë për të njëjtën zyrë?

Z. Y. Merkaj: Po bëhet fjalë për të njëjtën zyrë, por zyra ka patur në fasadën e saj logo dhe siglën e partisë si dhe materiale propagandistike dhe është konsideruar si zyrë zgjedhore e Partisë Lëvizja Bashkë.

Z. K. Bele: Duke barazpeshuar në mënyrë po e quaj të arsyeshme nevojën e subjektit për të ushtruar të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhje, për të patur seli si dhe rregullimin e udhëzimit të Komisionerit, a nuk do ishte e arsyeshme, si dhe duke patur parasysh edhe vendimin e djeshëm të KAS-it, me të njëjtën lëndë, ku u urdhërua heqja e materialeve të dukshme por jo mbyllja e selisë, a nuk do ishte më e arsyeshme që të mbahej i njëjti qëndrim nga Komisioneri? Pra, ju prezantua kjo Komisionerit?

Z. Y. Merkaj: Atëhere mbledhjet e Komisionit janë mbledhje publike, të cilat bëhen rregullisht me njoftimin e palëve dhe duhet të jenë në prezencën e palëve. Komisioneri i ka krijuar të gjitha kushtet që palët të marrin pjesë në shqyrtim administrativ, përsa kohë që këto nuk vinë, nuk ka kush i mbron pretendimet e tyre dhe raporti i monitoruesit ka qënë që kjo është zyrë zgjedhore, nuk është seli. Në këto kushte Komisioneri ka vendosur që kjo zyrë zgjedhore duhet të mbyllet pasi

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.05.2023*

nuk mund të lëviz Qendra e Votimit, por duhet lëvizur zyra zgjedhore. Këtë pretendim nuk e ka ngritur njeri në seancë, nuk është shqyrtuar, nuk është hetuar.

Z. K. Bele: Ne nga letrat na del kjo. Të drejtat e palëve i mbron ligji, pastaj palët mund të vinë ose jo, megjithatë nuk kam pyetje tjetër.

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit! Pyetje të tjera? Jo. Atëhere në përfundim zoti Merkaj çfarë kërkoni?

Z. Y. Merkaj: Ne kërkojmë lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, urdhërimin e policisë, por tani është zbatuar kështuqë...

Z. E. Çefa: Është zbatuar? Është mbyllur zyra?

Z. Y. Merkaj: Është mbyllur zyra, po.

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit. Atëhere KAS do tërhiqet për vendim pak minuta.

Rifillon seanca

Ora 22:14

Z. E. Çefa: Riçelim seancën për shpalljen e vendimit lidhur me kërkesën ankimore numër 60, atëhere KAS pasi e diskutoi çështjen në tërësi vendosi:

- pranimin e ankimit të ankimuesit të subjektit zgjedhor Lëvizja Bashkë;
- shfuqizimin e pikës 2, të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 496, datë 11 maj 2023;

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.13.05.2023*

- lejin e ushtrimit të aktivitetit të zakonshëm të Partisë Lëvizja Bashkë në selinë e saj, me adresën rruga Abdulla Keta, numër 1.
 - Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet subjekti zgjedhor Lëvizja Bashkë, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Tiranë.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.
- U shpall sot në datën 13 maj 2023.
Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 111

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

